



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.389/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Industria e Mishit Kalabria” Sh.p.k, kundër të paditurës Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të aktit administrativ Nr.142/20 të datës 11.11.2020, jashtë seancës me datë 08.03.2024

A K T V E N D I M

- I. **KONSIDEROHET** e tërhequr padia e paditësit “Industria e Mishit Kalabria” Sh.p.k, kundër të paditurës Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të aktit administrativ Nr.142/20 të datës 11.11.2020.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “Industria e Mishit Kalabria” Sh.p.k, ka parashtruar padi kundër të paditurës Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të aktit administrativ Nr.142/20 të datës 11.11.2020,

Gjykata me datë 09.02.2024 ka caktuar seancë. Paditësit nuk i është përgjigjur dhe mungesën nuk e ka arsyetuar ndërsa ftesën për seance e ka pranuar me datë 25.01.2024. Ne seance ka përfaqësuar përfaqësuesi i të paditurës B.B. me autorizim. Gjykata ka konstatuar se paditës nuk e ka paguar taksën gjyqësore, me datë 19.10.2021 gjykata i ka dërguar vërejtjen për pagesë të taksës, më të

cilën e ka ftuar paditësin që brenda afatit prej 15 ditëve nga marrja e kësaj vërejtje, t'a paguaj taksën gjyqësore për padi, në shumën prej 50 euro, duke e paralajmëruar paditësin se nëse nuk e paguan taksën gjyqësore për padi, brenda afatit të caktuar, do të konsiderohet se padia është tërhequr konform nenin 63 të Ligjit për Konfliktin Administrativ lidhur me nenin 253 par.5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Andaj, gjykata konsideron se paditësi është tërhequr nga padia, dhe ka vendosur si në pikën I të këtij aktvendimi, duke e përfunduar procedurën në këtë çështje administrative.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

Ka.nr.389/22, datë 08.03.2024

Gjyqtarja
Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komeriale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.